



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 22.7.2024

**Lënda:** Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 661, datë 18.5.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Besnik Hoxha

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit

*Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,*

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha kërkimet dhe propësimet e palëve, Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të datës 3.7.2023, parashtrimeve me shkrim të depozituara në Kolegj në seancën gjyqësore të datës 17.7.2024, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së nr. 377/1 prot., datë 19.6.2023, pjesë e ankimit, për secilin shkak, në mënyrë të përmbledhur vlerëson se:

**I. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë**

1. *Për pasurinë: godinë banimi 3-kate në Shkodër*, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni me aktin “Rezultatet e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit z. Besnik Hoxha”, të datës 13.4.2023<sup>1</sup>, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç, të aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën, pasi ka konstatuar se:

(i) *Duket se ka mospërputhje mes deklarimeve të subjektit, sa i përket periudhës së ndërtimit të banesës, mes Deklaratës Vetting, ku përshkruhet periudha 2003 – 2013 dhe në përgjigje të pyetësorëve ku përmendet periudha 2003 – 2007;*

<sup>1</sup> Referohuni “Rezultateve të hetimit kryesisht...”, f. 8.

(ii) *Duket se subjekti nuk ka deklaruar shpenzimet/investimet e kryera në lidhje me pasurinë godinë banimi 3-katëshe, përgjatë viteve 2003 – 2007;*

(iii) *Duket se për ndërtimin e banesës në fjalë përgjatë periudhës 2003 – 2007 (sikurse është konfirmuar nga ortofotot), subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në **masën -3.455.325 lekë**. Megjithatë, edhe nëse do të konsiderohej sipas deklarimit në Deklaratën Vetting, gjithsesi do të rezultonte një mungesë e burimeve të ligjshme financiare në **masën -3.298.417 lekë**;*

(iv) *Duket jobindës pretendimi se mobilimi i një banese 3-katëshe të ketë kushtuar vetëm 300.000 lekë.*

1.1 *Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, bazuar në Rekomandimin e ONM-së nr. 377/1 prot., datë 19.6.2023, referuar edhe në prapësimet e subjektit të rivlerësimit depozituar në seancën e datës 17.7.2024, vlerëson se, në përfundim të këtij procesi, për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 3.7.2023 dhe parashtimet e Komisionerit Publik të datës 17.7.2024, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me kohën e ndërtimit dhe investimit në këtë pasuri, si dhe kostot/shpenzimet e ndërtimit dhe mobilimit të saj, duke mos provuar kështu dhe burimet e ligjshme të përdorura për krijimin e saj, për sa konstatuar nga Komisioni.*

1.2 *Në përfundim për këtë pasuri, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në të gjitha variantet alternative të shpërndarjes së shpenzimeve dhe kryerjes së analizës financiare mbi ndërtimin e pasurisë në fjalë (si 2003-2007, ashtu dhe 2003-2013), ndodhen në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me pasurinë “Godinë banimi trekatëshe”, ndodhur në Shkodër, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b”, dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë kontekst, duket se nuk gjen zbatim aplikimi i parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit nga ana e Komisionit, pasi pamjaftueshmëria financiare e konstatuar në rastin konkret, nuk është në masën/vlerën që të mund të gjejnë zbatim këto parime të aplikuara deri tani në jurisprudencën e Kolegjit, gjatë kontrollit të kriterit të pasurisë. Duke mbajtur në konsideratë edhe elemente të tjera të konstatuara për rastin, nisur nga përmbajtja e nenit 4, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, është e qartë se parimi i proporcionalitetit nuk mund të merret dhe të interpretohet i shkëputur për relativizuar pasaktësinë në deklarim dhe pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme në krijimin e pasurisë godinë banimi 3-kate, të ndodhur në Shkodër, duke u shmangur kështu nga detyrimi për deklarim me vërtetësi të tërësisë së pasurisë dhe shpjegimit bindshëm të ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj.*

2. *Për pasurinë: apartament banimi, në rr. “\*\*\* \*\*”, Tiranë, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni me aktin “Rezultatet e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Besnik Hoxha”, të datës 13.4.2023<sup>2</sup>, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç, të aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën, pasi:*

(i) *Duket se subjekti i rivlerësimit ka qenë dhe vijon të jetë i vetmi përdorues/posedues, në mënyrë të pandërprerë, i pasurisë në analizë, ndonëse ndër vite janë ndryshuar porositësit dhe pronarët e apartamentit në fjalë. Në këto kushte, Komisioni ngre dyshime se kjo mund të jetë një pasuri e krijuar me mjete financiare të subjektit të rivlerësimit, për llogari të tij dhe e padeklaruar, me qëllim shmangien e verifikimit të burimeve të përdorura për krijimin e saj;*

<sup>2</sup> Referohuni “Rezultateve të hetimit kryesisht...”, f. 20.

(ii) *Duket se huadhënësi, z. \*\*\*, ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare, prej – 9.524.478 lekë, për dhënie e huas prej 107.500 euro, subjektit. Për rrjedhojë, duket se subjekti i rivlerësimit, në momentin e kryerjes së pagesës së kështit të parë të apartamentit në analizë, ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej – 9.524.478 lekë;*

(iii) *Duket se ka pasur një deklaram të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit, përgjatë procesit të rivlerësimit, sa i përket vendbanimit të familjes së tij, përgjatë periudhës 2010 – 2015.*

2.1 *Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, bazuar në Rekomandimin e ONM-së nr. 377/1 prot., datë 19.6.2023, referuar edhe në prapësimet e subjektit të rivlerësimit depozituar në seancën e datës 17.7.2024, vlerëson se në përfundim të këtij procesi, për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 3.7.2023 dhe parashtrimet e Komisionerit Publik të datës 17.7.2024, nuk u provua e kundërta e barrës së provës lidhur me përpjekjen e subjektit për të paraqitur ndryshe interesat pasurorë me këtë pasuri dhe momentin e posedimit të saj. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës edhe lidhur me burimet e ligjshme të huadhënësit \*\*\*, \*\*\*, dhe si rezultat dhe burimet e ligjshme të vetë subjektit për pagesat në momentin e porositjes së kësaj pasurie nga ai në vitin 2011. Sjellim dhe vëmendje këtu dhe faktin se për sa trajtuar gjerësisht në ankim dhe parashtrime, apartamenti në fjalë, edhe pse ka qenë objekt i disa transaksioneve nga blerës të ndryshëm, rezulton të jetë përdorur dhe gëzuar vetëm nga subjekti i rivlerësimit.*

2.2 Në përfundim, për sa trajtuar gjerësisht në ankim dhe parashtrime të Komisionerit Publik, nisur nga: (i) deklaramet kontradiktore dhe jo të vërteta të subjektit të rivlerësimit, mbi kohën, adresat e banimit dhe vendqëndrimin për periudhën që nga viti 2010 e vijim; (ii) transaksionet e vazhdueshme ku shfaqet subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë me ndërthurje të interesave privatë mes tyre; (iii) posedimi dhe gëzimi në mënyrë të pandërprerë i së njëjtës pasuri nga ana e subjektit të rivlerësimit, objekt i këtyre transaksioneve; si dhe (iv) pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme të huadhënësit, z. \*\*\*, \*\*\*, për të dhënë huan në vlerën 107.500 euro, në vitin 2011, subjektit të rivlerësimit, në vlerësimin e Komisionerit Publik, bazuar në Rekomandimin e ONM-së nr. 377/1 prot., datë 19.6.2023, janë fakte të cilat, të vlerësuara në tërësi, çojnë në përfundimin se, më së paku, subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në fjalë dhe interesat e vërteta pasurore të tij, rrethana këto që çojnë në aplikimin e nenit D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, situatë e cila duhet të vlerësohet edhe në vështrim të nenit 4, pika 2, në lidhje me nenin 61, pika 5 e këtij ligji.

3. *Për shpenzimet e udhëtimit, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni me aktin “Rezultatet e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Besnik Hoxha”, të datës 13.4.2023<sup>3</sup>, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç, të aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën, pasi nga analiza financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për periudhën e deklaramit 2003-2016, ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ në vlerën - 6.293.084 lekë<sup>4</sup>.*

3.1 *Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, bazuar në Rekomandimin e ONM-së nr. 377/1 prot., datë 19.6.2023, referuar edhe në prapësimet e subjektit të rivlerësimit, depozituar në seancën e datës 17.7.2024, vlerëson se në përfundim të këtij procesi, për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 3.7.2023 dhe parashtrimet e Komisionerit Publik të datës 17.7.2024, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, duke mbetur kështu e paprovuar*

<sup>3</sup> Referohuni “Rezultateve të hetimit kryesisht...”, f. 25.

<sup>4</sup> Paraqitur nga Komisioni dhe në formë tabelore në f. 26 të aktit “Rezultate hetimi kryesisht...”. Kjo analizë përfshin edhe pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar lidhur me investimin/shpenzimin për pasurinë *Godinë banimi 3-katëshe*, por jo atë të vitit 2011, trajtuar në pikën 2 të këtyre prapësimeve.

mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për të mbuluar me burime të ligjshme investimet dhe shpenzimet ndër vite, në të cilat një zë të konsiderueshëm zënë shpenzimet e udhëtimit, llogaritur në vlerën rreth 8.4 milionë lekë.

3.2 *Komisioneri Publik*, për sa trajtuar gjerësisht dhe në ankimin e datës 3.7.2023 dhe parashtrime të datës 17.7.2024, vlerëson se deklaratat e depozituara nga subjekti mbi mbulimin e shpenzimeve të akomodimit dhe udhëtimit, depozituar vetëm pas kalimit të barrës së provës, duhet të vlerësohen si përpjekje e tij për të pasqyruar në mënyrë jo të vërtetë dhe me qëllim justifikimin e pamjaftueshmërisë së konstatuar, e si të tilla, ato nuk duhet të merren në konsideratë dhe shpenzimet e udhëtimit duhet të llogariten mbështetur në metodologjinë e përcaktuar nga Kolegji në vendimin (JR) nr. 11/2019<sup>5</sup>.

3.3 Në përfundim të sa më sipër, *Komisioneri Publik* vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b”, dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

4. *Lidhur me përdorimin e automjeteve në pronësi të të tretëve*, Komisioni me aktin “Rezultatet e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Besnik Hoxha”, të datës 13.4.2023<sup>6</sup>, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç, të aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën, pasi:

*(i) duket se subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me sa parashikohet në nenin D, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nuk ka deklaruar në Deklaratën Vetting përdorimin e automjetit tip Mercedes Benz<sup>7</sup>, me targë \*\*\*, në përdorim nga subjekti gjatë periudhës 2014-2018.*

4.1 *Komisioneri Publik*, në analizë të akteve të administruara, bazuar në Rekomandimin e ONM-së nr. 377/1 prot., datë 19.6.2023, referuar edhe në prapësimet e subjektit të rivlerësimit, depozituar në seancën e datës 17.7.2024, vlerëson se në përfundim të këtij procesi, për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 3.7.2023 dhe parashtrimet e Komisionerit Publik të datës 17.7.2024, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës. Polica e sigurimit, e lëshuar në emër të subjektit të rivlerësimit, për periudhën 2014-2018, përbën provë, e cila tregon se përdorimi i automjetit nga ana e subjektit të rivlerësimit ka ndodhur gjatë këtyre viteve. Në këtë kontekst, referimi i Komisionit në vendimin (JR) nr. 42/2022, nuk mbështetet në situatën faktike të rastit në shqyrtim dhe nuk mund të merret në konsideratë. Komisioneri Publik, referuar vendimit (JR) nr. 12/2021 të Kolegjit, (pgr. 27.10 të tij), bazuar në Rekomandimin e ONM-së nr. 377/1 prot., datë 19.6.2023, në kontekstin e rrethanave të rezultuara nga aktet e administruara, të cilat referojnë se subjekti i rivlerësimit ka pasur në përdorim automjetin në fjalë, si para momentit të dorëzimit të Deklaratës *Vetting* dhe më pas, konstaton se mosdeklarimi i kësaj të drejte reale sjell në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është në shkelje të detyrimit të deklarimit sipas nenit D, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>5</sup> Përjashtim nga rasti në fjalë bëjnë vetëm kostot e qëndrimit për udhëtimet e subjektit dhe familjarëve në shtetin turk, për rastet kur udhëtimet janë bërë me linja ajrore të ndryshme nga Charter, sikundër konstatohet në disa raste, për shkak të lidhjes së afërt familjare të subjektit me shtetasin \*\*\*. \*\*\* (i vëllai), lidhje e provuar dhe e deklaruar dhe në faza më të hershme të hetimit administrativ.

<sup>6</sup> Referohuni “Rezultate hetimi kryesisht...”, f. 23.

<sup>7</sup> Automjet për të cilin kanë rezultuar polica sigurimi në emër të subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës 2014-2018.

## II. Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale dhe konfliktin e interesit

5. Në analizë të vendimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka konstatuar se (i) subjekti i rivlerësimit, gjatë ushtrimit të funksionit, mund të ketë vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka gjykuar çështje me palë procedurale me të cilat ka pasur marrëdhënie kontraktuale, shit-blerje të pasurive të paluajtshme; si dhe (ii) subjekti i rivlerësimit mund të ketë vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, apo atij në dukje, pasi ka gjykuar çështje me palë procedurale, me të cilat subjekti ka udhëtuar në të njëjtin mjet.

5.1 Për sa më sipër, me aktin “Rezultate hetimi kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Besnik Hoxha”, të datës 13.4.2023<sup>8</sup>, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, dhe paragrafin 5 të nenit Ç, të aneksit të Kushtetutës, i ka kaluar subjektit barrën e provës si më poshtë vijon:

5.1.1 **Për rastin e familjes “\*\*\*\*”**, pasi duket se krijimi i kësaj marrëdhënie interesi me përfituesit e trashëgimisë, familjen “\*\*\*\*”,<sup>9</sup> rreth një muaj pas vendimit të marrë nga subjekti, në procesin gjyqësor, pikërisht për çeljen e trashëgimisë në fjalë, ngre dyshime për cenimin e etikës së gjyqtarit<sup>10</sup>.

5.1.2 **Për rastin e znj. \*\*\*. \*\*\*.**, pasi duket se është cenuar etika e gjyqtarit, pasi për sa kohë subjekti ka pasur marrëdhënie interesi<sup>11</sup> menjëherë pas shqyrtimit të çështjeve me palët që kishin qenë në proceset e gjykuara prej tij, pavarësisht natyrës dhe objektit të çështjeve, duket se nuk mund të kishte diskrecion vendimmarrës apo hapësira favorizimi<sup>12</sup>.

5.1.3 **Për rastin e z. \*\*\*. \*\*\*.**, ndonëse çështja gjyqësore ka pasur natyrë deklarative, ku nuk është trajtuar apo zgjidhur ndonjë konflikt gjyqësor ndërmjet palëve<sup>13</sup>, edhe pse nuk evidentohet ndonjë favorizim i mundshëm i kërkuesve në këto vendimmarrje, ngrihen dyshime mbi disa rrethana konflikti interesi, të cilat, më së paku, mund të cenojnë etikën e gjyqtarit, nisur kjo nga marrëdhënia e ngushtë miqësore dhe e hershme me shtetasin \*\*\*. \*\*\*., fakt për të cilin do të duhej të ishte evituar shqyrtimi prej subjektit, i një çështjeje me kërkues apo palë pikërisht këtë person. Nisur nga fakti që konstatimet mbi rrethana të konfliktit të interesit dhe/ose të cenimit të etikës së gjyqtarit janë gjetur të përsëritura, duket se ato mund të kenë cenuar edhe besimin e publikut te figura e magjistratit dhe te sistemi i drejtësisë<sup>14</sup>.

5.1.4 **Për rastin e z. \*\*\*. \*\*\*.** ngrihen dyshime se subjekti mund të ketë shqyrtuar dhe vendosur për tri çështjet<sup>15</sup> që ka gjykuar me shtetasin \*\*\*. \*\*\*., në kushtet e konfliktit të interesit dhe/ose

<sup>8</sup> Referohuni “Rezultateve të hetimit kryesisht...”, f. 5; f. 47-50.

<sup>9</sup> Me kontratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., ka blerë një pjesë të pasurisë trashëgimore, shtëpi banimi, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Shkodër, në pronësi të familjes \*\*\*., për shumën 900.000 lekë.

<sup>10</sup> Referohuni “Rezultateve të hetimit kryesisht...”, f. 5.

<sup>11</sup> Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. \*\*\*., datë \*\*3.2010, ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë për të ndjerin \*\*\*.\*\*\*., duke njohur pjesët takuese të trashëgimtarëve ligjorë, ndërkohë që subjekti vetë ka lidhur dy marrëveshje me znj. \*\*\* (shkëmbim qiraje), respektivisht në datën \*\*8.2010, si dhe në datën \*\*2.2016, trajtuar në çështjen *apartment banimi, rr. “\*\*\*\*”*, Tiranë.

<sup>12</sup> Referohuni “Rezultateve të hetimit kryesisht...”, f. 47-48.

<sup>13</sup> Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. \*\*\*., datë \*\*3.2008, ka vendosur pranimin e padisë të palës paditëse \*\*\*.\*\*\*., për “Deklarimin pjesërisht të pavlefshëm të aktit të lindjes, për sa i përket vendlindjes së fëmijës \*\*\*.\*\*\*., i datëlindjes \*\*5.2001. Në të njëjtën kohë, subjekti i rivlerësimit ka marrë hua nga z. \*\*\*.\*\*\*. shumën 107.500 euro, në vitin 2011, për blerjen e apartamentit të përdorur prej tij në rr. “\*\*\*\*””, Tiranë. Gjithashtu, subjekti ka udhëtuar në shoqërinë e shtetasit \*\*\*.\*\*\*., në disa udhëtime, konkretisht: (i) në datën \*\*5.2007, shtetasi \*\*\*.\*\*\*. ka qenë drejtues i mjetit me targë \*\*\*., në pronësi të shtetasit \*\*\*.\*\*\*. (ii) Në datën \*\*8.2008, subjekti ka qenë drejtues i mjetit me targë \*\*\* (iii) Në datën \*\*3.2008, B. Hoxha ka qenë drejtues i mjetit me targë \*\*\* (iv) Në datën \*\*9.2011, \*\*\*.\*\*\*. ka qenë drejtues i mjetit me targë \*\*\*.

<sup>14</sup> Referohuni “Rezultateve të hetimit kryesisht...”, f. 50.

<sup>15</sup> Subjekti, me vendimin nr. \*\*\*/2009, subjekti ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore; Me vendimin nr. \*\*\*/2010, subjekti ka gjykuar çështjen me palë kërkuese, \*\*\*.\*\*\*., me objekt: “Kundërshtim i veprimeve përbarimore”; Me

duke shkelur etikën e magjistratit, për shkak të marrëdhënieve dhe udhëtimeve të kryera (së bashku) me palët në proces<sup>16</sup>, gjatë apo në afërsi të shqyrtimit të çështjeve gjyqësore përkatëse, nga vetë subjekti<sup>17</sup>.

5.2 *Komisioneri Publik*, në analizë të akteve të administruara, bazuar edhe në Rekomandimin e ONM-së nr. 377/1 prot., datë 19.6.2023, referuar edhe në prapësimet e subjektit të rivlerësimit, depozituar në seancën e datës 17.7.2024, vlerëson se në përfundim të këtij procesi, për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 3.7.2023 dhe parashtrimet e Komisionerit Publik të datës 17.7.2024, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës.

5.2.1 Pavarësisht natyrës së çështjeve të gjykuara nga subjekti, *Komisioneri Publik* vlerëson se është përgjegjësi e magjistratit të mos jetë pjesë e gjykimit në ato çështje kur ai ka lidhje të natyrës personale apo interesi me palët në gjykim. Subjekti i rivlerësimit, në rastet e lartpërmendura, ka gjykuar çështje të tilla duke mos respektuar parimet procedurale, që synojnë garantimin e paanshmërisë e gjykatës, si element i procesit të rregullt ligjor.

5.2.2 Konstatohet po ashtu se vendimi (JR) nr. 42/2022 i Kolegjit, mbi të cilin mbështetet Komisioni në vendimmarrjen e tij dhe subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij, nuk është relevant, pasi ky vendim referon në një tipologji tjetër të konfliktit të interesit. Rasti që referon ky vendim ka të bëjë me detyrat administrative të një drejtuesi në raport me ligjin nr. 9367/2005, “Për konfliktin e interesit” (i ndryshuar). Ndërsa në rastin konkret të subjektit të rivlerësimit, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me veprimtarinë gjyqësore/procedurale të tij si gjyqtar, rregulluar nga K. Pr. Civile, nenet 72 dhe 73, të tij, si dhe në kuadër të vlerësimit të kriterit të aftësisë profesionale.

5.2.3 Lidhur me natyrën e vendimeve, nëse ato deklarative duhet të jenë përjashtuese, siç ka pranuar Komisioni në arsyetimin e vendimit, Kolegji, në vendimin nr. 16/2019, prg. 30.2, ka standardizuar qëndrimin e tij, duke e gjetur një arsyetim të tillë: [...] *të pabazuar në ligj, pasi nuk përjashtohet ligjërisht asnjë çështje, qoftë kjo e konfliktit të kompetencave që të justifikojë qenien e gjyqtarit në vendimmarrjen e këtyre çështjeve gjyqësore, duke u ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit [...]*.

5.2.4 Përveç sa trajtuar për rastin e *familjes* \*\*\*, gjerësisht në ankimin e datës 3.7.2023 dhe parashtrimet e datës 17.7.2024, rezulton se edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit në parashtrimet e tij<sup>18</sup> në Kolegji, në seancën e datës 17.7.2024, se: [...] *sikundër ka deklaruar dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, banesën në fjalë e ka pasur në përdorim përpara se të përfundohej procesi i kalimit të pronësisë (pra, është dakordësuar me blerësin për blerjen e këtij ndërtimi dhe, për shkak të përgatitjes së dokumentacionit, kontrata është nënshkruar formalisht në gusht të vitit 2003), por banesën e ka marrë në dorëzim përpara dhe ka filluar të kryejë punime në të, sikundër rezulton dhe nga pamjet e marra në Google, të dorëzuara bashkëlidhur ankimit të Komisionerit Publik (ONM) të muajit maj 2003 [...] provon ekzistencën e gjendjes së konfliktit të interesit edhe gjatë shqyrtimit të çështjes të përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë \*\*.6.2003, për të cilën subjekti ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit*

---

vendimin nr. \*\*\*/2009, subjekti ka gjykuar çështjen me palë kërkuese, \*\*\*, \*\*\*, me objekt gjykimi: “1. Saktësim të kufitarëve të pronës etj. 2. Vërtetimin e faktit juridik dhe 3. Rivendosjen në afat të së drejtës për të paraqitur dokumentacionin e pronës”.

<sup>16</sup> Subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar jashtë vendit me shtetasit \*\*\*, \*\*\*, në një udhëtim 1-ditor, në datën \*\*.4.2010 - \*\*.4.2010, i cili ka qenë drejtues i mjetit me targë \*\*\*, në pronësi të tij.

<sup>17</sup> Referohuni “Rezultateve të hetimit kryesisht...”, f. 49-50.

<sup>18</sup> Referohuni parashtrimeve të subjektit të depozituara në Kolegji në datën 15.7.2024 (f. 5).



\*\*\* \*\*\*, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë bashkëshorten e tij, \*\*\* \*\*\*, dhe fëmijët \*\*\*. \*\*\*. \*\*\*. \*\*\*. e \*\*\*. \*\*\*.

5.2.5 Edhe për sa i përket çështjes dhe marrëdhënies së subjektit me huamarrësin, z. \*\*\*. \*\*\*, Komisioneri Publik vlerëson të ritheksojë se, sikundër trajtuar dhe në ankimin e datës 3.7.2023, kjo çështje nisur dhe nga informacionet e disponuara nga agjencitë ligjzbatuese rreth aktivitetit të paligjshëm, të referuar për subjektin e rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur me të, me të cilët ndërthuren interesat privatë (përshkruar në Opinionin dhe Rekomandimin e ONM-së, lidhja dhe veprimtaria e subjektit me \*\*\*. \*\*\*.<sup>19</sup>) *do të duhej të trajtohej në kontekstin e integritetit, që është pjesë e vlerësimit të aftësive profesionale*, referuar edhe vendimit të KPA-së nr. 3/2020, prg. 33.3<sup>20</sup>.

### **III. Konkluzione**

6. Komisioneri Publik, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, pikës 3 dhe 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

7. Ndryshimin e vendimit nr. 661, datë 18.5.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Hoxha.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**

---

<sup>19</sup> Në prg. 33 të ankimit lexo: [...] z. \*\*\*. \*\*\*, [...].

<sup>20</sup> [...] Së fundmi, në rast se do të rezultonte e provuar një marrëdhënie miqësie e ngushtë mes subjektit dhe huamarrësit, palë në procesin gjyqësor, në mungesë të rrethanave që dëshmojnë interes pasuror të përfutur nga subjekti në kushtet e konfliktit të interesit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kjo lloj situatë do të duhej të trajtohej në kontekstin e integritetit, që është pjesë e vlerësimit të aftësive profesionale [...].